



Prishtinë: 30.04.2010

Kodi i ZRRE-së: V_244_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_374_03_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_374_03_10** ;
5. Apeli i konsumatorit me datë 07.04.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë; dhe
7. Rregullën për shkyçje dhe rikyçje të konsumatorëve në sektorin e energjisë në Kosovë.

Në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2010, nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa e konsumatorit Muhamet Kadolli (shifra e konsumatorit në KEK: DPR – 7108) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 09.02.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 29.12.2009 lidhur me kontestimin e njoftimit për shkyçje dhe shkyçjes.

- Me datë 11.02.2005 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumatorë në KEK duke kundërshtuar njoftimin për shkyçje dhe shkyçjen nga ana e KEK-ut
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 29.12.2009 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar në arsyetimin se njoftimet për shkyçje dhe shkyçjet kanë arritur si rezultat i borxhit të energjisë elektrike ndaj ndërmarrjes së energjisë.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 03.12.2009
- Me datë 21.04.2006, KEK-u i ka dërguar konsumatorit njoftimin për shkyçje për shkak të borxhit që ka ndaj KEK-ut, ku borxhi i konsumatorit deri në atë kohë ka qenë 2,697.31 €. **Provë:** Transaksionet e konsumatorit

- Me datë 08.11.2006, KEK-u i ka dërguar konsumatorit njoftimin për shkyçje për shkak të borxhit që ka ndaj KEK-ut, ku borxhi i konsumatorit deri në atë kohë ka qenë 2933.76 €. **Provë:** Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 05.12.2006, punëtorët e KEK-ut e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik konsumatorin për shkak se nuk iu është përmbajtur kërkesave sipas njoftimit për shkyçje. Me realizimin e shkyçjes nga ekipet e KEK-ut konsumatori është ngarkuar me taksën për shkyçje në vlerë 57.50 €. **Provë:** Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 21.12.2006, punëtorët e KEK-ut e kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë vërejtur se konsumatori është rikyçur ilegalisht pasi ekipi KEK-ut paraprakisht me datë 05.12.2006 kishte shkyçur nga rrjeti elektrik konsumatorin për shkak se nuk iu është përmbajtur kërkesave sipas njoftimit për shkyçje. Me realizimin e shkyçjes nga ekipet e KEK-ut konsumatori është ngarkuar me taksën për shkyçje në vlerë 115.00 €. **Provë:** Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 12.01.2007 konsumatori Muhamet Kadolli ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumator për anulimin e dënimit për shkyçje që iu është bërë nga ana e KEK-ut. **Provë:** Kërkesa e konsumatorit e protokolluar në KEK me datë 12.01.2007
- Me datë 29.12.2009 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar si të pabazë. **Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 29.12.2009
- Me datë 09.02.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së. **Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 19.03.2010, DMK e ZRRE-së ka nxjerrë një vendim në lidhje me ankesën e konsumatorit duke e refuzuar ankesën e konsumatorit në arsyetimin se njoftimi për shkyçje dhe shkyçjet janë bërë sipas Rregullës për shkyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë. **Provë:** Vendimi i DMK në ZRRE me datë 19.03.2010
- Me datë 07.04.2010 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, duke kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_374_03_10. **Provë:** Ankesa e konsumatorit në Bord të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK_V_374_03_10 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së dhe me kornizën ligjore në fuqi. Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsytet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar